

## ENERGJI E GJELBËR DHE E QËNDRUESHME NË NDËRTE SAT E ELBASANIT - GREENELB

### Konteksti

Rrugëtimi i Elbasanit drejt neutralitetit klimatik përballet me sfida të ndjeshme, veçanërisht në sektorin e ndërtesave. Inventari i parë i gazeve serrë i qytetit tregon se ndërtesat janë kontribuesit kryesorë të emetimeve, ku konsumi i energjisë elektrike përbën 28.3%, ndërsa energjia jo-elektrike shton edhe 15.9% të emetimeve totale. Ndërtesat e banimit privat janë burimi kryesor, përgjegjëse për 96.8% të këtyre emetimeve.

Përmes Programit të Qyteteve Pilot NetZeroCities në kuadër të Misionit të BE-së për Qytetet Neutrale ndaj Klimës, ky projekt do të pilotojë zgjidhje inovative të eficiencës së energjisë në lagjen "Vullnetari" të Elbasanit. Kjo lagje do të shërbejë si terren testimi për zhvillimin dhe zbatimin e modeleve gjithëpërfshirëse të eficiencës së energjisë që më vonë mund të shkallëzohen në të gjithë qytetin.

### Qëllimi i projektit

Transformimi i godinave të Elbasanit në struktura me emetim pothuajse zero për të adresuar sfidat mjedisore dhe ekonomike, duke zhvilluar modeleve të eficiencës së energjisë dhe strategji inovatore të tilla si analiza e sjelljes, angazhimi social dhe duke nxitur një ambient fleksibël për testimin e politikave.

### Produktet dhe aktivitetet

- **Zhvillimi i modelit të eficiencës energjetike për ndërtesat pilot private në Elbasan:** përzgjedhja e ndërtesave pilot private në lagjen "Vullnetari", kryerja e vlerësimeve të detajuara të eficiencës energjetike në ndërtesa, zhvillimi i profileve energjetike të ndërtesave
- **Zhvillimi i planit teknik dhe financiar mbi masat e identifikuar të eficiencës energjetike në ndërtesa:** projektimi i zgjidhjeve të rinovimit për ndërtesat pilot, kryerja e analizës financiare, zhvillimi i një udhërrëfyese të zbatimit të masave.
- **Zhvillimi i kuadrit gjithëpërfshirës për ndryshimin e sjelljes dhe politikave për eficiencën energjetike:** analiza e sjelljes ndaj konsumit të energjisë, testimi i ndërhyrjeve të targetuara për ndryshimin e sjelljes, hartimi dhe testimi i politikës sandbox për eficiencën energjetike.
- **Forcimi i kapaciteteve të palëve të interesit për zgjerimin e projekteve të eficiencës energjetike:** trajnime të avancuar për eficiencën energjetike dhe vlerësimin komunitar; trajnime për përdorimin e modelit të standardizuar të vlerësimit të performancës, si dhe trajnime për planifikimin dhe menaxhimin e projekteve të rinovimit.



#### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

##### DONATORËT:

Bashkimi Evropian/ EIT Climate-KIC

##### PARTNERËT

- Bashkia Elbasan
- Instituti i Kërkimeve Urbane

##### KOHËZGJATJA:

01/09/2024 - 30/08/2026

##### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja  
11, Ap. 56 Tiranë, Shqipëri  
Tel.: +355694333808  
E : zvokopola@uri.org.al

### Rreth IKU-t

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.



**NET ZERO CITIES**  
EU MISSION PLATFORM | CLIMATE NEUTRAL AND SMART CITIES



Funded by  
the European Union